



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:201249

Datë: 14.09.2023

Numri i dokumentit: 04681349

C.nr.2819/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.S, nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Avokatura Istrefi” Sh.A., me seli në Prishtinë, rruga”Bill Clinton”, Hyrja numër 69, numër 1, kundër të paditurës “ P.....” SH.P.K, të cilën e përfaqëson Albin Xhemali, avokat në Prishtinë, Rruga “Holgen Petersen”, Objekti “Park Residence”, hyrja 4, kati 0, numër 2, me objekt të kontestit kompensim dëmi, vlera e kontestit 3,001.60€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, të datës 16.08.2023, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 01.09.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.S, nga Prishtina.
- II. DETYROHET e paditura P.....Sh.A., me seli në Fushë Kosovë, që emër të dëmit të material dhe jo material lidhur me lëndimin në punë, të datës 04.09.2017, për 80% të përgjegjësisë, paditësin ta dëmshpërblej në shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej..... 640.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej 528.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 100.80€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 100.80€

- III. DETYROHET e paditura që prestimet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditësit t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, 01.09.2023, e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.
- IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të dëmit jo material për dhimbje trupore - fizike shuma prej 640.00€ dhe për friken e pësuar shuma prej 528.00€, SI E PABAZUAR.
- V. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,149.00€ (njëmijë e njëqind e dyzet e nëntë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi, B.S, nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 23.10.2017, në këtë gjykatë, ka parashtruar padi, kundër të paditurës P.....Sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në padi, seancat gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, ka theksuar se ka qenë i punësuar tek e paditura, në vendin e punës punëtor pompe. Me datë 04.09.2017, rreth orës 08.40, derisa ishte në vendin e tij të punës, në Bresje Fushë Kosovë, duke furnizuar me derivate (plin) veturën e një klienti ka filluar të rrjedh plin, gjatë tërheqjes së dorezës nga vetura e klientit ka ardhur deri tek lëndimi i paditësit, të gjitha këto të konstatuara në raportin zyrtar të punës me numër 01 nr.25-71/2017. Me tej ka theksuar se në këtë fatkeqësi paditësi ka pësuar lëndime trupore, si djegie e të dy duarve, lëndime në këmbën e djathtë dhe lëndime të tjera. Mbi bazën e kësaj, duke u bazuar në nenin 5 dhe 6, paragrafi 3, të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, lidhur me nenin 60 të Ligjit të Punës dhe Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ta detyroj të paditurën që dëmin e pësuar paditësi nga lëndimi në punë me datë 04.09.2017, nga baza e përgjegjësisë objektive, për 80% të përgjegjësisë, ta detyroj të paditurën që t'ia kompensoj dëmin në lartësi të përgjithshme prej 3,001.60€, nga të cilat për dhembjet fizike shumën prej 1,600,00€, për friken shumën prej 1,200.00€, për ndihmën e personit të tretë

100.80€, për ushqim të përforcuar 100.80€, të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8% nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesë definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses së saj, në përgjigje në padi, seanca gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, me pretendimin se paditësi e ka shkaktuar vetë aksidentin, si pasojë e neglizhencës së tij, për çka e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse për lëndimet që i ka pësuar në aksident. Tutje ka theksuar se kërkesëpadia nuk është e bazuar në ligj pasi që e njëjta nuk është vërtetuar nga provat e administruara gjatë kësaj çështjeje kontestimore. Mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: Raportin Zyrtar të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës me numër 01.nr.25-71/2017, të datës 27.09.2017, Vendimin e Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës me numër 01.nr.25-71/2017A, të datës 28.09.2017, Raportin mjekësor me numër protokollit 35630, të datës 04.09.2017, lëshuar nga Qendra Emergjente Prishtinë, Ekspertizën nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në punë - shkaqet e lëndimit në punë të punëtorit B.S, punuar nga eksperti Azem Kyçyku, 02.11.2022, Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Ortopedisë, Kirurgjisë Plastike dhe Psikiatrisë, punuar me datës 07.06.2023, nga ekspertët Dr. Milazim Haxholli - Ortoped, Dr. Zenë Buja – Kirurg Plastik dhe Dr. Nazmije Musliu – Psikiatër.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi B.S, nga Prishtina, me datë 17.08.2017, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, me detyrë punëtor pompe, në njësinë numër 34 të të paditurës, Bresje, Fushë Kosovë, sikurse nuk ishte kontestues fakti se në këtë datë, i njëjti, deri sa ishte duke kryer detyrat e tij të punës – furnizim të automjetit me derivate (plin), kishte pësuar lëndime trupore.

Duke qenë se në rastin konkret nuk ishte kontestues fakti i lëndimit të paditësit në punë, me propozimin e palës paditëse, me qëllim që të vërtetohen lëshimet eventuale të ndërgjyqësve në shkaktimin e aksidentit, Gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi Siguria dhe Mbrojtja në punë.

Eksperti Azem Kyqyku, në ekspertizën e datës 02.11.2022, si dhe sqarimeve në seanca gjyqësore, ka konstatuar se aksidenti në punë i datës 04.09.2017, ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë duke vendosur GLN/LPG (propan-buan gazin) në rezervuarin e automjetit të klientit. Lëndimi i punëtorit ka ndodhur nga kontakti me vrushkullin e gazit të dalur nga gryka e injektorit, respektivisht nga gryka që shërben për vendosjen e gazit në rezervuarin e automjetit. Eksperti ka konstatuar se shkaqet e lëndimit në punë janë lëshimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Lëshim i punëdhënësit janë: nuk ka bërë vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës, nuk ka trajnuar punëtorin nga lëmia e Sigurisë dhe Mbrojtjes në Punë, nuk ka pajisur punëtorin me PPM adekuate, që në këtë rast dorëzat kanë qenë të rëndësishme, nuk ka dërguar punëtorin në kontrollim mjekësor para angazhimit në punë për të marrur mendimin e mjekëve se i njëjti a i plotëson kushtet shëndetsore, fizike dhe psikike për t'u angazhuar në punët konkrete, nuk ka paraqitur dëshmi se pajisja shpërndarëse, respektivisht injektor/pishtoli i saj ka qenë në gjendje të rregullt teknike në kohën e ndodhjes së aksidentit. Eksperti ka konstatuar se edhe pse punëmarrësi nuk ka pasur trajnime të kryera dhe nuk ka pasur përvojë të gjatë të punës tek e paditura, i njëjti ka pasur udhëzime për punë të shkruara në shpërndarësin e GLN-së. Andaj, si lëshim të punëmarrësit ka gjetur: nuk ka pasur vëmendjen dhe koncentrimin e duhur gjatë kryerjes së veprimit, sepse nëse pishtoli ka dalur prej grykës së rezervoarit si pasojë e mosfunksionimit të nofullave që e sigurojnë qëndrimin e pishtolit në grykën e rezervoarit të automjetit gjatë mbushjes, ai e ka mbajtur me dorë të shtypur pishtolin. Në momentin që pishtoli është nxjerrur ose ka dalur prej grykës, dorëza që e hap ventilin e rrjedhjes së gazit është dashtë të mos mbahet e shtypur dhe të mos kthehet, ose mos të lejohet të kthehet, gryka e pishtolit kah trupi i punëtorit. Rasti tregon se punëtori e ka humbur koncentrimin dhe nuk ka mundur t'i kontrolloi veprimet e veta. Eksperti ka konstatuar se në këtë rast domonojnë lëshimet e punëdhënësit.

Gjykata, ekspertizën nga mbrojtja dhe siguria në punë e ka pranuar në tërësi si të besueshme, pasi që e njëjta, në vlerësimin e gjykatës, ishte e punuar në mënyrë profesionale dhe e argumentuar, brenda vëllimit të detyrave të dhëna nga gjykata, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Nga Raporti zyrtar i Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, me numër 01.nr.25-71/2017, i datës 27.09.2017, gjykata ka provuar faktin se e paditura nuk ka ndërmarr veprimet ligjore për njoftimin e Inspektoratit të Punës lidhur me lëndimin në vendin e punës, të datës 17.08.2017, të këtu paditësit B.S.

Nga vendimi numër 01.Nr.25- 71/2017A, i datës 28.09.2017, të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, gjykata ka vërtetuar faktin se për shkak të mos lajmërimit të lëndimit në punë të punëtorit B.S, ndaj të paditurës është shqiptuar gjobë, bazuar në Ligjin numër Nr.04/L-161

Ndërsa nga Raporti mjekësor me numër protokolli 35630, i datës 04.09.2017 lëshuar nga Qendra Emergjente Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi, pas 18 ditëve nga koha e lëndimit në punë, ka kryer kontroll mjekësor për shkak të lëndimit të marrë në punë.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve të paditësit, nga lëndimi i datës 04.09.2017, me propozimin e palës paditëse, Gjykata ka nxjerrë provën me ekspertiza mjekësore, me ekspertë nga lëmi i Ortopedisë, Kirurgjisë Plastike dhe Psikiatrisë, punuar me datë 07.06.2023, nga ekspertët, Dr. Milazim Haxholli – Ortoped, Dr. Zejnë Buja – Kirurg Plastik dhe Dr.Nazmie Musliu – Psikiatër.

Eksperti i Kirurgjisë Plastike Dr. Zejnë Buja dhe eksperti i Ortopedisë Dr. Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit B.S, kanë konstatuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të tij në vendin e punës, ka pësuar lëndime, si: djegie sipërfaqësore (gr,I,IIa) dhe me sipërfaqe trupore deri në 5%, dhe është konstatuar cikatrikse të thjeshta – simplekse, pa pengesa funksionale, të vlerësuara si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka pësuar dhimbje dhe atë: dhimbje me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 1 dite, për shkak të djegies së shuplakave të duarve dhe kërcirit të majtë. Dhimbje me intensitet të mesëm ka pasur për 18 ditë, kohë pas kohë gjerë në marrjen e terapisë adekuate kundër dhimbjes, e të cilat ndërlidhen me kohën e nevojshme për shërimin e djegieve të indit lëkuror të dy shuplakave të duarve. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, ekspertët kanë konstatuar se ka qenë e nevojshme e në kohëzgjatje prej 18 ditësh, e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike si: veshmbathja, ushqimi, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollet sistematike, pasi këto nevoja nuk ka mundur t'i plotësoj vet si pasojë e paaftësisë së pjesshme e shkaktuar nga djegia e duarve. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, karbohidrate të

nevojshme për sanimin e indeve të djegura dhe reaksionit post traumatik. Ekspertët kanë konstatuar se për paditësin nuk ka qenë i nevojshëm rehabilitimi fizioterapeutik, nuk ka pasur shëmtim trupor dhe nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Nazmie Musliu, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi B.S, si pasojë e lëndimit në punë, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar për disa sekonda, si frikë nga kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizikë. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 ditëve, në formë të çrregullimit të gjumit, ëndrra të këqija, zgjime të shpeshta me rikujtime të ngjarjes traumatike. Frikë të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 muaj, e shoqëruar me gjendjen e reagimit akut ndaj stresit, brengës për ecurinë e mjekimit dhe frikës nga pasojat e djegies, çrregullime të gjumit, nervozë, indisponim, pasiguri. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar 2 muaj.

Gjykata, ekspertizat mjekësore nga lëmi i Ortopedisë, Kirurgjisë Plastike dhe Psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që e njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në faktet e vërtetuara, gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (LP), Ligji Nr 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (LSSHP) dhe Ligjit NR. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), të cilat ligje kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko – detyrimor.

Me nenin 42, paragrafi 1, dhe 2, Mbrojtja e përgjithshme në punë, të LP-së është paracaktuar se”
1. I punësuar ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. Paragrafi 2. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.”

Me nenin 60, paragrafi 1, të LP-së është përcaktuar se “punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t’ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.”

Me nenin 5 paragrafi 1 të LSSHP-së, është përcaktuar se “Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës”, kurse në nenin 6, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj është përcaktuar se “Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.”

Neni 21 i LSSHP parashihen detyrimet e të punësuarit paragrafi 1. “Çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave të tjerë në punë, në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi.”

Me nenin 136 të LMD-së është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.”

Me nenin 137 të LMD-së është përcaktuar se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”

Me dispozitën e nenit 154 të LMD-së është përcaktuar se “dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.”, ndërsa me dispozitën e nenit 155 të ligjit të njëjtë është përcaktuar se “për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.”

Me nenin 176, paragrafi 1, të LMD-së, është përcaktuar se “I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.”

Gjykata, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura dhe gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj dhe

vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo sepse nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, provave të administruara, është provuar fakti se me datë 04.09.2017, në objektet e të paditurës, përkatësisht në hapësirat ku ka qenë i angazhuar i punësuar, tani paditësi, B.S, në pompen e derivateve Petrol Company, në Bresje, Fushë Kosovë, deri sa ishte duke punuar në vendin e tij të punës, ka ndodhur aksident në punë dhe në të njëjtin ka pësuar lëndme trupore këtu paditësi, Bardhi Osmani. Aksidenti në punë, bazuar në konstatimet e ekspertit nga mbrojtja dhe siguria në punë, janë si shkak i lëshimeve të punëdhënësit dhe punëmarrësit, me dominim të lëshimeve të punëdhënësit, i cili nuk ka bërë vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës, nuk ka trajnuar punëtorin nga lemia e Sigurisë dhe mbrojtjes në punë, nuk ka pajisur punëtorin me PPM adekuate, që në këtë rast dorëzat kanë qenë të rëndësishme, nuk ka dërguar punëtorin në kontrollim mjekësor para angazhimit në punë për të marrur mendimin e mjekëve se i njëjti a i plotëson kushtet shendetsore, fizike dhe psikike për t'u angazhuar në punët konkrete, nuk ka paraqitur dëshmi se pajisja shpërndarëse ka qenë në rregull në kohën e aksidentit. Ndërsa lëshim i punëmarrësit ka qenë se nuk ka pasur vëmendjen dhe koncentrimin e duhur gjatë kryerjes së veprimit, sepse nëse pishtoli ka dalur prej grykës së rezervoarit si pasojë e mosfunksionimit të nofullave që e sigurojnë qëndrimin e pishtolit në grykën e rezervoarit të automjetit gjatë mbushjes, ai e ka mbajtur me dorë të shtypur pishtolin. Në momentin që pishtoli është nxjerrur ose ka dalur prej grykës, dorëza që e hap ventilin e rrjedhjes së gazit është dashtë të mos mbahet e shtypur dhe të mos kthehet, ose mos të lejohet të kthehet, gryka e pishtolit kah trupi i punëtorit. Rasti tregon se punëtori e ka humbur koncentrimin dhe nuk ka mundur t'i kontrolloi veprimet e veta.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë, sipas kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e dëmit, dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 80% për të paditurën “Petrol Company” Sh.P.K., ndërsa 20% për paditësin, kjo bazuar në nenin 173 dhe 176 të LMD-së, lidhur me nenin 60 të LP-së. Ndajra e përgjegjësisë është bërë duke vlerësuar lëshimet e të dy palëve në shkaktimin e aksidentit në punë, të listuara si në ekspertizën nga Mbrojtja dhe Siguria në Punë.

Gjykata, gjen se për lëndimet e punëtorit në punë, dëmtuesi – në këtë rast e paditura, përgjigjet sipas përgjegjësisë objektive, të paraparë me Nenin 136 paragrafi 3 të LMD-së, pavarësisht fajit, ndërsa paditësi, si kontribuues në shkaktimin e dëmit, bazuar në nenin 176 të LMD-së, ka të drejtë në kompensimin e pjesës së dëmit në përpjesëtimisht me kontributin e tij në shkaktimin e incidentit dhe dëmit.

Gjykata, në këtë procedurë, ka provuar faktin se e paditura nuk ka përmbushur obligimet nga neni 42, paragrafi 2, i LP-së, ku është përcaktuar se “Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.” E paditura, nuk ka arritur të provojë me asnjë provë materiale (sipas Neni 319.1 dhe 322.3 të LPK-së), se ka ndërmarrë trajnime nga lëmia e sigurisë në punë (Neni 6 par.1 dhe Neni 20 të LSSHP) apo se ka bërë kontrollimin mjekësor të punëtorit për të vërtetuar nëse gjendja shëndetësore e tij (qoftë fizike apo psikike) për të përmbushur detyrat e vendit të tij të punës, punëtor pompe të derivateve, (Neni 13 par 1.6 LSSHP). Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ka respektuar obligimet ligjore të parapara me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të vlerësuara si më lartë.

Pretendimi i përfaqësues së të paditurës se aksidenti në rastin konkret ka ardhur pa fajin e të së paditurës, respektivisht nga lëshimet e paditësit, gjykata e vlerëson si të pabazuar, sepse me asnjë provë nuk u vërtetua se deri të aksidenti ka ardhur nga lëshimet ekskluzive të paditësit, por se i njëjti vetëm i ka kontribuar shkaktimit të aksidentit. Së këndejmi, e paditura në cilësinë e punëdhënësit, ka për obligim që të kompensojë punëtorin – këtu paditësin sipas përgjegjësisë objektive, mbi bazën e dispozitave të Neni 60 të Ligjit të Punës dhe Neni 6 par 3 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Gjykata, mbi bazën e gjendjes faktike të provuar si më lartë dhe dispozitave ligjore të sipërcituara, pas vlerësimit të të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, vlerësimit të ekspertizave mjekësore, dhe kontributin e paditësit mbi shkaktimin e dëmit, miratoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, në vlerën e shpërblimit të dëmit si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shumat e gjykuara paraqesin dëmshpërblim prej 80% të dëmit të pësuar nga paditësi në aksidentin në punë, të datës 04.09.2017.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në shumë prej 960.00€, në vlerë të 80% të dëmit të pësuar nga lëndimi në punë, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i Kirurgjisë Plastike dhe Ortopedisë është provuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 04.09.2017, kishte pësuar lëndime të lehta trupore, e që ishin: djegie sipërfaqësore (gr,I,IIa) dhe me sipërfaqe trupore deri në 5%, dhe është konstatuar cikatrikse të thjeshta – simplekse, pa pengesa funksionale, të vlerësuara si lëndime të lehta trupore. Si shkak

i këtyre lëndimeve, paditësi kishte përjetuar dhimbje fizik me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 1 ditë, dhimbje fizike me intensitet të mesëm prej 18 ditëve.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 672.00€, në vlerë prej 80% të dëmit të pësuar, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i psikiatrisë është provuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 04.09.2017, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 ditëve, Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 2 muaj.

Gjykata, vlerëson se shumatat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditësit si satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe shkallën e shëmtimit trupor. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimi e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë të dëmit jomaterial.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, ka aprovuar shumatat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësit i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili

përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar, ka caktuar kompensimin në shumën prej 100.80€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse nga ekspertiza mjekësore është provuar fakti se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 04.09.2017, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 18 ditëve.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 100.80€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, nga se nga ekspertiza mjekësore është provuar fakti se paditësi, ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë në kuptim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, në kohëzgjatje prej 18 ditëve.

Gjykata, ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuar pretendimet e të paditurës se deri tek lëndimi në punë i paditësit ka ardhur me fajin e tij, pasi që nga provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, si Ekspertiza nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, është vërtetuar fakti se deri tek aksidenti në punë ka ardhur me lëshime dominuese të të paditurës, që do të thotë se e paditura mban përgjegjësi primare në shkaktimin e aksidentit në punë, ndërsa paditësi mban përgjegjësi sekondare.

Gjykata, nuk ka aprovuar propozimin e përfaqësuesit të palës paditëse për marrjen e provës me ekspertizë të re, nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, pasi që në vlerësimin e gjykatës ekspertiza e punuar me datë 02.11.2022, nga eksperti Azem Kyçyku, dhe sqarimet e dhëna prej tij në seancë gjyqësore të datës 30.03.2023, kanë qenë profesionale, duke evidentuar saktë rrjedhjen e aksidentit në punë, shkakun e lëndimit të punëtorit, lëshimet e palëve dhe kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit në punë.

Gjykata, nuk ka administruar si prova në këtë procedurë kontestimore deklaratat e pretenduara si të dhëna nga Faruk Ibrahimimi dhe Ramadan Shabani, bazuar në nenin 428, paragrafi 2 të LPK-së, por edhe për faktin se përpiluesit pretenduar të tyre kanë mundur të propozohen që të dëgjohen si dëshmitar në këtë çështje juridike.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata, për dëmin material fillon të rrjedh nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, bazuar në kërkesën e paditësit, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së OAK-së, sipas së cilës paditësit i pranohen shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 1,149.00€ (njëmijë e njëqind e dyzet e nëntë euro). Shpenzimet e procedurës të njohura paditësit janë: 104.00€ për përpilim të padisë, 405.00€ për përfaqësim e paditësit nga avokati në tri seanca gjyqësore të mbajtura (3 seanca nga 135.00€), 150.00€ për marrjen e provës me ekspertizë nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, 450.00€ për marrjen e provë me ekspertiza mjekësore, 40.00€ për taksë gjyqësore për padi. Shpenzimet e procedurës të njohura në këtë çështje juridike për përpilim të padisë dhe për përfaqësim të paditësit në seancat gjyqësore nga avokati, janë përlllogaritur bazuar në tariforin 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifatat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€ si dhe nenin 452, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2819/17, me datë 17.08.2023

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.